



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK**

(Adresa, Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës e-mail: info@vaudejes.gov.al)

Nr. 6819 Prot.

Vau Dejës me 20/11 /2025

PROJEKT VENDIM

PËR:

"Për humbjen e mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës"

Komisioni i mandateve të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 49, pika 2, pika 4 germa e, pika 5 dhe neni 54 germa j, i propozon Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, të:

VENDOSI:

1. Miratimin e mbarimit përpara afatit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës **Z. Aleko Dodani**, mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 49, pika 4 germa (e) për shkak se nuk ka marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit të Bashkisë Vau Dejës për një periudhë 6 mujore.

Kryetari Këshillit

Ervis Shimaj





BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK

(Adresa, Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës e-mail: info@vaudejes.gov.al)

RELACION

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 49, pika 4, germa e, dhe në rregulloren nr.23 datë 24.04.2020 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Vau Dejës" neni 21, pika 1, germa g, ju raportoj si më poshtë:

Këshilltari i Këshillit Bashkiak Vau Dejës, Z. Aleko Dodani (përfaqësuese e subjektit politik P.S.D) nuk ka marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak Vau Dejës për një periudhë 6-mujore rresht, dhe konkretisht: Nga mbledhja e muajit Maj 2025 deri në mbledhjen e muajit Tetor 2025. Sqaroj se Këshilli Bashkiak Vau Dejës ka zhvilluar mbledhje normale të radhës për ç' do muaj dhe një mbledhje jashtë radhe në muajin Qershor datë 05.06.2025 si më poshtë:

Mbledhja e muajit Maj është bërë me datë 26.05.2025.

Mbledhje jashtë radhe është bërë me datë 05.06.2025.

Mbledhja e muajit Qershor është bërë me datë 26.06.2025.

Mbledhja e muajit Korrik është bërë me datë 25.07.2025.

Mbledhja e muajit Gusht është bërë me datë 29.08.2025.

Mbledhja e muajit Shtator është bërë me datë 29.09.2025.

Mbledhja e muajit Tetor është bërë me datë 27.10.2025.

Në të gjitha këto mbledhje të Këshillit Bashkiak Vau Dejës, Këshilltari Z. Aleko Dodani ka munguar pa shprehur ndonjë arsye.

Sa më sipër :

Kryetari Këshillit

Ervis Shimaj

